



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 694/4 Prot.

Tiranë, më 23.10.2018

V E N D I M

Nr.84, Datë 23/10/2018

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE, (EITI - SHQIPËRI), MINISTERIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Infrstrukturës dhe Energjisë.

VËREJ SE:

Me Vendimin nr. 59, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Infrstrukturës dhe Energjisë.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës

në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 500/1 prot., datë 6.6.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 500/2 prot., datë 6.6.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse”*, i është njoftuar Drejtuesit të Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, institucioni Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja e tij në *“listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, si pjesë e sistemit të shërbimit civil, është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1 (numri rendor 82), të Vendimit nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 694 prot., datë 31.8.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Me shkresat nr. 694/1 prot., datë 31.8.2018 dhe nr. 694/2 prot., datë 31.8.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrstrukturës dhe Energjisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 52/2 prot., datë 10.10.2018, *“Përgjigje lidhur me projektraportin, “Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin “Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri)”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të. Nga ana tjetër, subjekti i mbikëqyrur, ka informuar Komisionerin në lidhje me masat e marra

për të rregulluar gjëndjen e ligjshmërisë në aspektet e konstatuara si parregullsi gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil dhe të pasqyruara në materialin e paraqitur nga grupi i mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, për të rregulluar situatën e ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 67, datë 9.10.2017, të nxjerrë prej tij, për emërimin e përkohshëm të punonjësit ******, në pozicionin Drejtues i Sekretariatit, EITI-Shqipëri dhe të rregullohen pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me ligjin në këtë pozicion.

Njësia e ngarkuar për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të shpallë pozicionin të lirë, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

3. Institucioni i mbikëqyrur, t’i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të konfirmojë zyrtarisht nëse përshkrimet e punës janë hartuar në përputhje me legjislacionin specifik që përcakton detyrat për pozicionin e punës, apo formatin

standard të miratuar në këtë rast, ashtu si parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

- Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse, përshkrimet e punës t’i përcillen për miratim Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë së linjës, i cili finalizon këtë proces duke nënshkruar përshkrimet e punës në ndarjen përkatëse, pasi nënshkrimi i formularit të përshkrimit të punës nga ana e tij, nga eprori direkt dhe nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, është një detyrim specifik, i parashikuar në pikën 18, 19 dhe 20, të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar.
 - Në përfundim të procedurave si më sipër, një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelat aneks, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
 5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
 6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri) dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 7. Për këtë vendim të njoftohet Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, (EITI-Shqipëri), Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrstrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
 8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e parregullive të konstatuara, sipas parashikimeve të

pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha